



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6540 Prot.

Roskovec, më 01, 10 2021

VENDIM
NR 80 .DATË 30 .09 .2021

“PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN NR.89, DATË 02.12.2020 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT DHE NUMRIT MAKSIMAL TË PUNONJËSVE TË BASHKISË ROSKOVEC, PËR VITIN 2021”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 25, pikat 1 dhe 2, nenit 54, shkronjat “ç”, “d”, “dh” dhe “f”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 214, pika 2, nenit 233, pika 3, shkronja “b”, nenit 275, pika 1, të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenit 5, shkronja “d”, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; pikës 17, të Vendimit nr. 165, datë 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njëjësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar; Udhëzimi Nr.2 datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.89 Prot datë 02.12.2020 “Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të bashkisë dhe të Ndërmarjeve Vartëse si dhe të nivelit maksimal të pagave për vitin 2021” si dhe të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec me nr.99 datë 30.12.2020 “Për krijimin e Muzeut Vendor Roskovec”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e një shtesë në vendimin e këshillit të bashkisë Roskovec Nr.89 datë 02.12.2020 “Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të bashkisë dhe të Ndërmarjeve Vartëse si dhe të nivelit maksimal të pagave për vitin 2021”, si më poshtë vijon:
 - Numri maksimal i punonjësve për bashkinë Roskovec” **nga 184 bëhet 185** punonjës. Konkretisht shtohet në organikën e bashkisë Roskovec:
 - **1 (një) punonjës**
2. Fondi të përballohet nga fondi për pagat dhe sigurimet shoqërore të miratuar për vitin 2021.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska

